

**20261381996**

Në bazë të nenit 16, paragrafi 1, nënparagrafi 6 të Ligjit të Menaxhimit të Pasurisë së Konfiskuar, Dobisë Pasurore dhe Gjësendeve të Sekuestruara në Procedurë Penale dhe Kundërvajtëse (\*) (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 64/24, 37/25, 86/25, 101/25 dhe 135/25) dhe në pajtim me nenin 15, paragrafi 1, nënparagrafi 6 të Statutit të Agjencisë së Menaxhimit të Pasurisë së Sekuestruar nr. 02-4368/2 të datës 2.12.2024, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Menaxhimit të Pasurisë së Sekuestruar, në seancën e 8-të për vitin 2026, të mbajtur më 27.5.2026, miratoi si në vijim

**RREGULLORE PËR MËNYRËN E DHËNIES NË PËRDORIM TË PASURISË SË  
KONFISKUAR DHE GJËSENDEVE TË SEKUESTRUARA PËR RIPËRDORIM  
SOCIAL**

Neni 1

Me këtë rregullore rregullohet mënyra e dhënies së pasurisë së konfiskuar dhe gjësendeve të sekuestruara për ripërdorim social, në pajtim me Ligjin e Menaxhimit të Pasurisë së Konfiskuar, Dobisë Pasurore dhe Gjësendeve të Sekuestruara në Procedurë Penale dhe Kundërvajtëse (\*) (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 64/24, 37/25, 86/25, 101/25 dhe 135/25).

Neni 2

Ripërdorimi social paraqet dhënien e pasurisë së konfiskuar dhe gjësendeve të sekuestruara për përdorim nga organet shtetërore, si dhe nga shoqatat dhe fondacionet me karakter social.

Neni 3

Pasuria e konfiskuar dhe gjësendet e sekuestruara mund të jepen për ripërdorim social nëse janë të përshtatshme për përdorim dhe nëse nuk nevojiten për procedura të tjera.

Neni 4

Vendimin për dhënien e pasurisë së konfiskuar dhe gjësendeve të sekuestruara për ripërdorim social e miraton Këshilli Drejtues i Agjencisë së Menaxhimit të Pasurisë së Sekuestruar.

Neni 5

Kërkesë për dhënien e pasurisë së konfiskuar dhe gjësendeve të sekuestruara për ripërdorim social mund të paraqesin organet shtetërore, si dhe shoqatat dhe fondacionet me karakter social.

Në kërkesë detyrimisht duhet të specifikohet qëllimi i përdorimit, periudha e përdorimit dhe përshkrimi i pasurisë së nevojshme.

Neni 6

Agjencia bën verifikimin e përmbushjes së kushteve dhe përcakton përshtatshmërinë e kërkesës.

Agjencia kryen vlerësimin nëse pasuria e konfiskuar dhe gjësendet e sekuestruara janë të përshtatshme për dhënie dhe e kontrollon gjendjen e tyre.

Neni 7

Pasuria e konfiskuar dhe gjësendet e sekuestruara jepen pa kompensim, përveç nëse me vendim të veçantë përcaktohet ndryshe.

Neni 8

Organet shtetërore, shoqatat dhe fondacionet janë të detyruara ta përdorin pasurinë e konfiskuar dhe gjësendet e sekuestruara ekskluzivisht për qëllimin e përcaktuar në kërkesë dhe t'i mirëmbajnë në gjendje të rregullt.

Neni 9

Organet shtetërore, shoqatat dhe fondacionet nuk kanë të drejtë që pasurinë e konfiskuar dhe gjësendet e sekuestruara t'ua japin organeve dhe institucioneve të tjera shtetërore.

Neni 10

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pas hyrjes në fuqi, kjo rregullore do të publikohet edhe në faqen e internetit të Agjencisë.

Nr. 02-2558/1  
27.5.2026  
Shkup

Agjencia për Menaxhimin e  
Pronës së Konfiskuar  
Këshilli Drejtues  
Kryetari,  
**Станко Китаноски, d.v.**